# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-452864**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Eurodeputetja greke e ekstremit të djathtë sulmon ashpër Von der Leyen: Nuk ka raciste më të madhe kundër evropianëve se ju |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/eurodeputetja-greke-e-ekstremit-te-djathte-on-ashper-von-der-leyen-nuk--i586736` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 16:16:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 16:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `071beee60a3c6ab35d6269a58a7d0c9c15642cf78834797f6897ead6761a7d11` |
| TEKSTI | `e4592a6f2dddee931ac9c406f938e31ed1b3d74d815143ea22648a12808dc097` |
| PAMJA | `9eb0730903d09fa14b35492408681a812ff0cddd727ea055ee92d851cac19cfd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8f127a899cfeec6944fcf18f17855c9e3b5fdf050aacba6182171b2417a70052` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8f127a899cfeec6944fcf18f17855c9e3b5fdf050aacba6182171b2417a70052`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Eurodeputetja greke e ekstremit të djathtë sulmon ashpër Von der Leyen: Nuk ka raciste më të madhe kundër evropianëve se ju

TemA
17 Shtator 2026, 18:10Bota TEMA



Debati mbi Gjendjen e Unionit në Parlamentin Evropian është shoqëruar me përplasje të forta politike, ku eurodeputetja greke Afroditi Latinopoulou ka lëshuar akuza të ashpra ndaj Presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Latinopoulou e cilësoi kreun e Ekzekutivit Evropian si "racisten më të madhe kundër evropianëve", duke e bërë përgjegjëse për politikat e migracionit të paligjshëm dhe ndikimin e tyre në vendet e bllokut.

Gjatë fjalës së saj, eurodeputetja akuzoi Brukselin se po e mbush Evropën me emigrantë të paligjshëm dhe po krijon ndasi nëpër lagjet e qyteteve evropiane. Ajo nënvizoi se shtetet e vijës së parë, përfshirë Greqinë, po mbajnë koston kryesore të këtij fenomeni, ndërsa institucionet evropiane mjaftohen me leksione mbi vlerat. Përveç emigracionit, Latinopoulou kritikoi ashpër Marrëveshjen e Gjelbër dhe politikat klimatike të BE-së, duke i cilësuar ato si arsyen kryesore për mbylljen e fabrikave dhe humbjen e vendeve të punës në kontinent.

Sulmi i eurodeputetes greke u shtri edhe te çështja e transparencës, ku ajo riktheu në vëmendje shkëmbimin e mesazheve mes Von der Leyen dhe drejtuesit të kompanisë Pfizer, Albert Bourla, gjatë periudhës së negociatave për vaksinat kundër COVID-19. Latinopoulou kërkoi llogaridhënie të plotë nga Komisioni Evropian, duke e akuzuar drejtuesen e tij për mungesë transparence në vendimmarrje.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Jordania dhe Franca nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi në mbrojtje]

16:50 Bota

[Kryeministri i Suedisë jep dorëheqjen pas humbjes së zgjedhjeve]

16:40 Bota

[Mbreti Çarls paralajmëron udhëheqësit e IA-së për rreziqet nëse teknologjia bie në duar të gabuara]

16:32 Bota

[Irani i përgjigjet Merzit: Gjermania po paraqet një narrativë "të shtrembëruar" për luftën dhe programin bërthamor]

15:00 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.